



REPUBLIKA E SHQIPERISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 499/1 Prot.Kukës me, 18.09.2024**Lënda :** Kthim përgjigje.**Drejtuar:** Qendra "Res Publica"**Adresa:** Rruga: Bl "Gjergj Fishta, Nd. 24, H. 3, Ap. 7

TIRANË

Në përgjigje të kërkesës suaj Nr. 132/24 Prot datë 04.09.2024, hyrë në protokollin e Bahkisë me Nr. 499 Prot datë 06.09.2024 "Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit" ju bëjmë me dije se:

Shoqëria "Palushi" sh.p.k nuk disponon leje për ndërtimin e HEC "Palushi".

Për Shoqërinë "HEC Palushi" sh.p.k Bashkia disponon:

- 1- Miratimin Paraprak për vazhdimin e procedurave për ndërtimin e "HEC Palushi" Nr. 6748/2 datë 19.06.2018 të lëshuar nga Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë.
- 2- Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës me Nr. 121 datë 22.05.2020 "Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave ligore për heqjen nga fondi pyjor/kullor në funksion dhe përdorim të Shoqërisë: "Palushi" sh.p.k.
- 3- Shoqëria "Palushi" sh.p.k nuk ka filluar punimet për ndërtimin e HEC-it.

Bashkëlidhur po ju dërgojme dokumentacionin ligjor të cilin disponon Bashkia Kukës për shoqërinë "Palushi" sh.p.k.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

KRYETARI

Albert HALILAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

VENDIM

Nr. 121 Datë 22.05.2020

PËR

**DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE LIGJORE PËR
HEQJEN NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR NË FUNKSION DHE PËRDORIM
TË SHOQËRISË "PALUSHI" SH.P.K**

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës 22.05.2020, pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave si dhe bazuar në ligjin Nr.139/2015 të miratuar me datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nënart 8/2, 9/1/1.1/b, 54, ligjin Nr.138/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emerohen ose ushtrojnë funksione publike" nënart 14/5, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative të RSH", ligjit Nr.9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar (i ndryshuar) nënart 17, ligji Nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullor" (i ndryshuar) nënart 10, VKM Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish-Komunave/Bashkive", VKM Nr.247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave dhe kërkesave të proçedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore" VKM Nr.591, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.1353, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të proçedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor" (i ndryshuar) pika 5/ç, VKM Nr.592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor", (i ndryshuar), pika 6/d, si dhe shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit Nr.988/1 Prot. datë 13.02.2020,

VENDOSI:

1.Të miratojë dhënien e dakortësisë për vijimin e proçedurave ligjore për heqjen nga fondi pyjor/kullor në funksion dhe përdorim të objektit HEC "Palushi".

2. Te miratoje dhenien ne perdorim nga fondi pyjor/kullosor (ekonomia pyjore Bicaj - Kolosjan) te nje sipersfaqe prej 0.625 ha, qe preket nga ndertimi i HEC "Palushi", per:

a).Ngastrat me te dhenat e meposhtme: 41,34,

Me kufizimet:

- Veriu: Toke bujqesore
- Jugu: Toke bujqesore
- Lindje: Perroi i Shejes
- Perendimi: Toke bujqesore

3.Afati i dhenies ne perdorim eshte 3 (tre) vjet, me te drejte rinovimi.

4.Shprehja e dakortesise do t'i dergohet Ministrise se Turizimit dhe Mjedisit dhe Agjensise se Bazenit Ujor Drine Bune per vijimin e procedurave ligjore te heqjes nga fondi pyjor/kullosor.

5. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Pyjeve dhe Kullotave.

6. Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Kukes.

